


Giosafatte Capparelli – Malcori

RRËFIME TË MOÇME ARBËRISHT

FJOKU



*Malcori*



**Giosafatte Capparelli – Malcori**

**RRËFIME TË MOÇME ARBËRISHT**

**FJOKU**

**Via Roma 98 – 87010 Acquaformosa  
347/4776511 e-mail: malcori.firmoza@gmail.com**

**Stampato in proprio - Acquaformosa dicembre 2019**



## Fjoku

Njëherë e dikur na ish, në Abërinë tonë të moçme, një Fjok Bek Kalladhepsi i Bregut të Malit, i cili ka qënë një tjerres i hollë dhe një dhelpër e vjetër.

Të gjithë Kalladhepsët ishin të ardhur në katundin tonë, dhe ky, Fjoku ynë, për të cilin jemi ture rrëfyer, shpinë e kish shumë pranë shpisë së Rinës së Këmbagjelravet; me Rinën ishin jo vetëm gjitonë por edhe shinjanjëra, sepse Rinës i kish pagëzuar djalin e vogël.

Rinës, pak vjet përpara i kish vdekur i shoqi, dhe e kish lënë vetëm me tre bil të vegjël, një gadhjure (1) pjakë me anë të së cilës ajo shurbeni (2) dherat, disa pula dhe një gjel gjymsë pa penda, tetë krerë dhi e një derk të majmë. E gjitha këtu ish bëgatëria e Rinës; sa për të holla: ng'bëfej fjalë fare.

Asi moti, shkoi vera, shkoi vjeshta dhe erdh dimri. Një dimër acar, ashtu si duhej e si gjithë gjindja e kërkoni për festën e



therjes së dirqvet. Por Rina ng'dini si të bëni asi viti. Asaj i mangojin të hollat për të paguar daxin (3), dhe ng'mund t'e (4) vritni derkun pa, pastaj, paguar të zezin dax. Pra, kështu, ajo rrini, afër vatrës, në një ndër ato ditë të ftofta shëndreu të atij moti, e tërë e hjimisur (5) në këso mundimesh, kur gjithë një hërje, iu duk se një dritë e vogël zu fill të zbardhni në mendjen e saj.

«Si ng'u dhe fare, e shkreta u! pse mos t'i thom Fjokut? Ai është shumë i zoti për të zgjidhur këto shurbise (6), dhe ka, patjetër, për të më gjetur udhën sa për të dalë frëng (7) nga ky i shkreti dax.» Bjuani Rina në kocën e vet.

Të nesërmen me natë, sapo zbardhi mirë dita e re, Rina, ende me çerën të vrënjtur, ashtu si është çera e njeriut kur këtij të fundit gadhjuri i ka ngrënë bukën e ditës së punës, u anangas (8) t'i ngit derën Fjokut.

Kumbari e priti me nder të madh, ashtu si pritën shinjanjërat, i dha të ulej dhe i shtroi kafetë, pëstaj, si pa se ndrikulla kish marrë frymë, e pyeti për gjindjen e shpisë, dhe se ku e kish krimbin e zi që i vrëni dhe i trubulloni aq shumë çerën e ng'e lëni të qete.

«Eh, kumbar, mor kumbar!», zu fill t'i ndani të keqen që i kish rarë. «Erdh moti për të therur derkun, dhe ng'kam si t'e vras pse ng'mundem të paguanj daxin, gjëndem pa të holla fare.» E këtu, Rina, si tha këto fjalë, ia nisi me një të qarë, dhe një lak (9) i madh e shtrëngoi.

«Pse, moj ndrikull, të mbjakesh (10) për kaq pak? Kemi për të gjetur një udhë për të dalë frëng. Mos u mbjak!» Me këto fjalë, Fjoku zu e i dha zëmër Rinës, ndërsa me kocë vej ture argalisur (11) shurbise jo shumë të mira për ndrikullën.

«Mirr vesh mirë, ndri, çë kem të bëmi: nesër mbrëma, para se të bierë mirë nata mbi katundin tonë, na kem të thermi derkun, kem t'e ndami katrish, e mishtë, sa për t'u ftofur mirë, kem t'e

fshefmi atje lart, nën qaramidhevet të shpisë sate. Sapo të difet dita e re, ti ndrikulla ime, do të dalësh jashtë ka (12) shpia e me gjithë fuqinë që ke në kurm, do të thërresh se të kanë vjedhur mishtë e derkut. Mos harro: thërrit fortë, dhe mirr bé, tek e fundit, gjindja e katundit do të t'e ketë besë. Dhe kështu do të dalësh frëng nga daxi.»

Si tha Fjoku, të nesërmen, ashtu u bë.

Rina, atë natë, si thertën derkun, e qetë ra në gjumë, dhe fjet një gjumë të ëmbël e të thellë. Kur zbardhi dita e re, u zgjua dhe shkoi për të parë mishtë. Në vend të mishit, që ng'ish më, pa vetëm qaramidhet e nxjerra e të çara. E zeza menjëherë pushtroi (13) Rinën, e cila, mbjatu (14), muar vesh se e kishin vjedhur.

Aty për aty mendja i vate tek kumbari, tek Fjoku. U ngre, u vesh e i shkoi në shpi.

Fjoku, me të vërtetë, atë ditë, e pritni Rinën. Ndodhej jashtë shpisë, dhe bëni sikur ndreqni ndonjë shurbes, kur i gjegji zërin ndrikullës. Ngrëjti kocën, pa Rinën, dhe, sikur të mos kish ndodhur faregjë në mes të tyre, i thotë: «Mirë se vjen, moj Rinë, eja, eja, hyr mbrënda se bën ftoftë!» Rina, kur iu u afrua shpisë, i tha: «O kumba, m'e vodhtën mishtë». Dhe i përgjigjet Fjoku: «Mirë, kështu thuaji të gjithëve!». Dhe Rina, nga ana e saj: «Me të vërtetë të thom, të gjithë mishtë më kanë vjedhur, ng' më lanë faregjë, kime besë.» Dhe Fjoku: «Kështu do të thuash, edhe mua që të kam mësuar!» Rina, që nani vej ture humbur shpresat, shtoi: «Për shpirtin e Zonjës së Bekuar, o Fjok, m'e kanë vjedhur të tërë, s'më kanë lënë asnjë asht.» Dhe Fjoku: «Thërrit më fort, thërrit më fort... se kështu të gjithë t'e kanë besë!»

Rina, atëherë, e pa se ish pa vlerë çdo fjalë më shumë me kumbarin, dhe pa e tjerur gjatë uli kocën përdhe, dhe me bishtin anamesa (15) shalëvet i ra udhës së shpisë.



Fjok Bek Kalladhepsi i Bregut të Malit e hëngri mishtë e derkut të Rinës.

---

(1) derr; (2) punonte; (3) tatimin; (4) ta; (5) e zhytur; (6) gjëra; (7) falas; (8) nxitoi; (9) dënesë; (10) të mërzitesh; (11) duke kurdisur; (12) nga; (13) e pushtoi; (14) menjëherë; (15) midis.

## Kreshmesha

Dielli, në ato ditë të fund marsi, ndërsa po ulej ture iu afruar kurrizit të Malit të Montesë, ku prapa tij, edhe pak, e do të fshehej për t'u prejtur edhe atë ditë, ashtu symadh dhe i zjarrtë si po dukej, nisi të kuqërrisni muret dhe dritaret e vjetra të shpisë së lalë Fatlumis. Ato mure dhe dritare të mëdha që ruanin ka (1) perëndimi dhe që derdheshin sipër një shesh të vogël e vezak, i cili, si për magji, kish dalë në formë petikoi nga bashkimi i dy shpive të mëdha: shpia e Kaluqërave me atë të Llafkrave.

Na, fëmijët e gjitonisë sonë, asi moti, gëzoheshim ture kaluar pjesën më të madhe të ditës në këtë shesh të vogël e vezak, anfiteatër i lodrave e i ëndrrave fëmijërore tona, të cilit i kishim qepur emrin: "Bregu i Vogel".

Lidhej ky, nga ana lart, me Bregun (o Bregun e Madh) me anë të një rrugicje që shkonte nën shpisë së Kaluqërave, kurse, nga



ana poshtë, me Sheshin e Madh (o Sheshin e Qishës) me anë të një shkallje që, ture zdrepur (2), shkoni nën shpisë së Lafkrave, ndërsa, nga ana perëndimore, aty, që të kuptohemi, ku petikoi qëndron hapur dhe nuk krijon, si zakonisht, një gjymsë rrethi, një udhëz (3) shumë e ngushtë, aq sa një gadhur (4) i ngrakuar me barrë sa mënxit mund të hyni, e lidhni me gjitoninë e Shpellës.

Atë ditë marsi të vonuar, sperat (5) e diellit trakulues (6) e të prushtë, ture rarë mbi qelqet e dritareve, çaheshin e këputeshin në dysh ture shtuar fuqinë e tyre, ndërkohë që çdo gjë veshej me një të kuqe të çelur dhe krijoni në tërë atë gjitoni të vogël një atmosferë ëndërruese në të cilën bini në sy shëmtira e një nusje (7) kashtje e veshur me të zeza; ish plakë, e thatë, e ashpër, njerkë, vajtuese, dhe rrini varur aty, dhjâ tek ëndi (8) i djathtë të dritares së ndarjes (9) së zjarrit të shpisë së lalë fatlumit; rrini nën shkëlqimin e atyre qelqeve, me furkë e bosht ndër duar, dhe ndër këmbë mbani një kokërr portokalje ku ishin ngulur në rreth si sperat e diellit shtatë penda pulje.

«Kjo është Kreshmesha», foli lalë Fatlumi, kur na pa të tërmosur (10) përpara asaj pamjeje që, ndërsa çelni fantazinë tonë, edhe na këllit në shpirt pak lemeri, aq e shëmtuar ish dukja e saj.

Gjatë fëmijërisë sime, lalë Fatlumi, ashtu si kam thënë edhe në disa rrëfime të tjera, ishte pjesëtari i fundit ~~te~~ familjes fisnike të Lafkrave, një nga dyert e mira të katundit tonë. Kish kaluar, aso kohe, të shtatëdhjetat, e shkoni ditët që i mbeteshin para që të ndërroni jetë ture shkoqur kujtimet e veta, ture diovasur (11), ture shkruar, dhe nëng mangojin (12) rastet që na kushtoni neve, fëmijët e gjitonisë së Bregut të Vogël. Të paharruara janë historitë dhe ndodhitë që na rrëfyeni, dhe mbresa të forta e të pashlyeshme ende ruami në kujtesën tonë; të gjitha na i diovasni (lexonte) nga një libër dorëshkrim që kish bërë don Eroku, një lalë i tij, që kish jetuar

në mote të moçme aq sa ai vetë ng' e mbani fare mend. Atë dorëshkrim, lalë Fatlumi, e ruani si sytë e ballit.

Në dimër, kur moti ish keq, o kur, në mënyrë të papritur, rrëpirni (13), o kur vorea fryni ture ulëritur anamesa rrugicave, o kur bora zbardhni udhë, sheshe, fusha e male, e nga qaramidhet e shpive të ulta vareshin dhjetëra e dhjetëra kanarikul (14), që si helle akulli arrinin njera në truall, dhe një i ftohtë i thatë të pritni çerën: *dimra acari kemi shkuar*, rrëfyejin pjeqtë tanë.

Në motra si këto, kur dimri egërsohej dhe i ngulni dhëmbët e thonjtë katundit tonë, e bora bini me ditë e javë të tëra, aq sa të dukej se ajo ng' bini vetëm nga qieli në dhé, por edhe nga dheu në qiell, atëherë na i shkojm (15) në shpi lalë Fatlumint, e jo pa e lajmëruar përpara, ture i shtruar pyejtjen e zakonshme: «Sa nesh mund të vimi?»; përgjigja, gjithmonë, ish po ajo, dhe ngaherë e shoqëruar me një buzëqeshje: «Aq sa mban vatra!». Ndërsa, me motin e mirë, Bregu i Vogël me muret e larta që e rrethojn, me ato hyrje e dalje që kish në tri anë të tij, arrini të kish një ajrisje parrajsore që me të vërtetë t' e kish ënda të kalonje aty ditë të tëra. Kështu se, atë ditë të fund marsi, nën sperat e atij dielli pranveror që po trakulonte, i kumbisur me kurrizin mbi murin e shpisë së tij, lalë Fatlumi zu fill të na kallëzoni, pasi që ndreqi zërin e uli shapkën aq sa të pengoni diellin që të mos t' i bini ndër sy, historinë e Kreshmeshës.

«Kreshmesha ish gruaja e Karnivalit. Ajo qëndroi vetëm, kur i shoqi gjet vdekjen të martën e Ditëve Hua (16) të motit 18\*\*.

Ky njeri njihej në katër anë e vendit si i pandënduri (17) më i mirë i gjithë botës, ish i zoti të hani e të pini për ditë e net të tëra pa të sosur fare. Dhe rasti i mirë i duall, dhe atë ng' e la t' i shkoni humbje, mbas Ditës së të Vdekurëve të atij moti.



Nisni java e të Lidhurave. Shtatë ditë të tëra, plus dy të marra hua, për të ngrënë, të pirë e të këcyer para Kreshmës së Madhe, gjatë së cilës do të ruheshin dyzetë ditë agjërimi më të pjot e meta-ni më të thella në përgatitjen e Pashkëve të Mëdha.

Karnivallit ng' i shkoi dëmë asnjë ditë, gjatë asaj jave: hëngri e piu me të madhe, ditë e net këcei e këndoi, shpinë e vet e lërei, edhe të shoqen ng' desh t' e dini më se ku ish, njera kur, ture u dirë (18) e marta e Ditëve Hua, mbi një shkallë druri, i vdekur e i startarosur (19), me buzët që i kishin mbetur të shpërveshura, të varura, të trasha e të fryta si dy copa mish të zier, nga të cilat, ashtu i shtrirë si(ç) ish mbi shkallës, i kulloni vera e tepërt, me barkun e frytë, aq sa dukej se do t' i dilni nga këmisha dhe nga çasti në çast të pëlsitë, me këmbët përpara, katër nga shokët e tij më të ngushtë ia qelltën (20) të shoqes, Kreshmeshës.

Gjindja e katundit disi e tromaksur nga pasojat e festavet dhe të verës, por edhe gjithashtu të porsa rarë nga shtrati, atë menatë, mbani vesh sa të xëni të rejat e asaj natje. Dhe ndërsa gojë më gojë, derë më derë, gjithë më gjithë përhapëj lajmi i lemerishëm të vdekjes së Karnivalit, Pjeqësia e katundit, edhe ajo pak e tromaksur nga kjo ndodhi, pa humbur mot, u mbjodh, dhe anangast (21) vendosi rreth kësaj vdekje, dhe, me gojë të Kryepjakut, shpalli programin e ditës:

“Pjeqësia, këtu e mbjedhur sot, e marta e Ditëve Hua të motit 18\*\*, gjegji martritë (22), këndoi kartat, muar parasysh bëmat e të ndjerit gjatë kësaj jave, dhe e gjykoi atë “Grykëmadh” (23). Vendimi, që e nderuara Pjeqësi ka lëshuar, do të bëhet i ditur para popullit, në formën cerimoniale ashtu si(ç) e kërkon tradita jonë e lashtë, po sot mbasdite në orën katër te(k) Sheshi i Madh”.

Dy orë para orës katër, ashtu si(ç) kish vendosur e nderuara Pjeqësi, gjindja e katundit zu të fularni (24) Sheshin e Madh para

Qishës së Madhe. Gra, burra, pjeq e fëmilë, aty të grumbulluar, buthtonin në shprehjet e tyre një padurim të madh, dhe ture ndërruar fjalë me njëri tjetrin, ture dhënë mendime e gjykime, ture pushtitur deklarata se si do të përfundoni kurmi-kufomë i zotnisë Karnivalit Grykëmadh, ture qeshur, ture qarë e ture kënduar bëjin që ai shesh të brumbullini (25) nga të katër anët, dhjâ sikur aty t' u kishin derdhur disa gone (26) arëzash dhe atë vend t' e (ta) kishin pushtuar (27).

Gjindja veni ture u shtuar, po ashtu edhe thërritjet, të cilat u bënë edhe më shurduese kur, pak para orës katër, nga udhëza që ulej nga gjithë e Shpellës, dhe bini dhjâ në qëndër të Sheshit të Madh, katër burra, po ata të asaj menate (28) fatzeze, zdrepeshin nga pjesa e lartë të katundit ture mbajtur sipër mushkut (29) të tyre shkallën-tavut, ku, i frytë, i bubunjasur (30), ngjyrëmanushaqe, i vdekur dhe i startarosur, rrini i strirë kurmi-kufomë i Karnivalit Grykëmadh. Prapa vijin pas e shoqja Kreshmesha ture qarë e vajtuar, burra me arganete e karramunxa (31) dhe, në fund, një turmë fëmilësh që nxini si një re e mbarsur me shi, të cilët ture thërritur e këcyer ngrëjin në ajër shtëllunga buhoi (32) gjatë asaj udhëze.

Shkalla-tavut me Karnivalin sipër u vendos në mes të sheshit, njerëzit hodhën valle rreth të vdekurit, pinë, kënduan, ndërsa Kreshmesha, në këmbë të shoqit, qani fatkeqësinë e saj dhe vajtoni burrin e vet të vdekur:

“Oh e mjera u! Si të le (33) vetëm, u e shkreta? Oii, e zeza u! Kish të m' u kishin tharë e këputur këto këmbë? Oii, e zeza u! Thashë, atë, të pavlyerin e burrrit tim, ka për t' e (ta) ruajtur i Madhi Zot! Oii, e zeza u! Si ng' më gjeti edhe mua cinxulluza e zezë (34)? Oii, e mjera u!...”

Në orën katër pikë, ra një qetësi e madhe mbi sheshin para qishës dhe mbi gjithë katundin. Pjeqësia rrini aty, para derës së



madhe të qishës, ndërsa Kryeplaku bëhej gati të diovasni vendimin e gjyqit. Dhe, mbasi rregulloi zërin, me ton të lartë e madhështor, ashtu si(ç) e kërkoni cerimoniali, zu të këndonin vendimin e gjyqit: “Sot, e marta e Ditëve Hua të motit 18\*\*”, Pjeqësia e këtij katundi u mbjodh për të gjykuar sjelljen e Karnivalit Grykëmadh gjatë javës së fundit të jetës së tij. Dhe nga ato që gjegji nga marritë, nga këndimi i kartave, nga bëmat e tij që rrëfyefen gojë më gojë, duall në shesh se, gjatë kësaj jave të të lidhurave, Karnivali Grykëmadh piu shtatë bute me verë, hëngri pjot sallucica e hjiromer (35) njera (36) sa vdiq i startarosur si e shifni edhe ju. Për kaq sa thamë, ai baltësoi shpirtin e vet me mëkatin e grykësisë, parandaj kurmi-kufomë i tij dënohet me djegie. Pjeqësia e katundit urdhëron, gjithashtu, që të bëhet gati, këtu, te(k) ky shesh, një zjarr i madh me shkarpa të thata e me dru lisi e të digjet kurmi-kufomë i Karnivalit Grykëmadh para se të bierë muzgu, dhe, nesërmenatë, hit që do të mbetet pas djegies të shprishet e t’ë (ta) marrë lumi.” Me kaq, Pjeqësia e katundi la sheshin.

Gjindtë, të dhezur nga festa, nga vera, por edhe më shumë, nani, nga vendimi i Pjeqësisë, dukeshin të marrë. Thërrisjin e ulërijin edhe më fort se përpara, dhe kush me shkarpa të thata, kush me një krah dru lisi, ashtu si kish urdhëruar Pjeqësia e katundit, në një të hapur e të mbullitur sysh, bënë gati një zjarr aq të madhë sa flakët e tij zdallambarnin (37) tërë atë shesh të pafund, dhe nistën të përvëlojin e përsullojin për së largu. Sipër kësaj pisje (38), në të rarë muzgu i asaj ditje, u kumbis kurmi-kufomë i Karnivalit Grykëmadh.

Ra muzgu, ra edhe nata, por vallet, këndimet, të pirat, të thërriturat, të gjindjes rreth zjarrit, vazhduan njera para agut. Pëstaj, të lodhur e të këputur, secili muar udhën e shpisë së vet.

I tërë sheshi dhe katundi të zbratur mbanin erë shkrumë e hi. Aty, para atij zjarri gjymsë të shuar, mbeti vetëm Kreshmesha, e taraksur dhe e gurosur.

Të nesërmen u kish dirë e merkurra pas Ditëve Hua. Ende me natë, u fshi Sheshi i Madh, hit të grumbulluar u vu në disa thasë, dhe u shprish, ashtu si(ç) kish porositur e nderuara Pjeqësi, mbi lumin e kulluar që afër fare katundit rrjidh i qetë.

Çudi! Kreshmesha nga vendi ku e kish lënë gjindja e katundit një ditë para ng’ kish lëvizur fare; ashtu e tromaksur dhe e gurosur dukej se vazhdoni të qani e të përgjoni burrin e saj.

Ajo kish vdekur. Dhe vdekjen e saj katundi e muar vesh vonë, aty nga mesi i ditës.»

Që atë ditë, ajo nisi të simbolizoni Kreshmet e Mëdha. Tradita popullore e paraqet atë si një nuse pjakë, e shëmtuar dhe e thatë si një shkarpë, shenja këto të varfërisë, të mjerimit dhe të agjërimit; e veshur me petka popullore të zeza për vdekjen e të shoqit, dhe me furkë e bosht ndër duar, ture tjerrë, ajo u kujton të gjallëve rrjedhjen e ngadalshme të jetës së njeriut njera në vdekje; përfundon stolisja e saj me një kokërr portokale me shtatë penda pulje, të ngulura në formë rrethi si sperat e diellit, simbolizojnë ato shtatë javët e Kreshmeve të Mëdha. Të parat gjashtë nga këto penda, çdo të diel, si shkojin javët, hilqen e digjen, kurse e shtata e ka radhën të Shtunën e Madhe. Ajo hilqet e digjet bashkë me Kreshmeshën në të rarë kumborët hareshëm që paralajmërojnë ngjalljen e Krishtit, ndërkohë që prifti në qishë, ture shprishur fjeta dhafnie e petale lulesh, këndon: “Ngreu, o Perëndi, jetën gjyko... Anàsta o Theòs, krinon tin ghen...”

Këtu, duhet shtuar, fëmijë të dashur, se katundi ynë ng’ e ka pasur në traditë Kreshmeshën, përkundrazi, ng’ e njih fare. Qe ime shoqe, që është me origjinë ashtu si(ç) dini të gjithë ju nga katundi



arbëresh shumë afër tonit, e cila kur erdh mes nesh, bashkë me pajën e shpresat e nusërisë, suall (39) me vetë edhe Kreshmeshën. Kështu se, për herën e parë në katundin tonë, ajo u var në dritaren e shpisë sime. Por, gjithashtu, lipset të dihet, se edhe të tjerë katunde arbëreshe ng'ë kanë pasur në traditën e tyre. Kreshmesha i nget (40) tradites lëtire (41) ku, në mbarë vendin (Italinë) njihet me emra të ndryshëm: Quaremma, Coremma, Caremma... ka edhe kush thotë që ka lidhje me mitologjinë greke, prandaj ajo njihet edhe me emrin "Kloto" (Kloto, një nder tri Parkat; klothes = tjerrësja, ajo që me furkë e bosht tjerr(te) fatin e njerëzve).

Përfundomi kështu, ture thënë se arbëreshët Kreshmeshën e kanë marrë hua nga tradita lëtire. I kanë rregulluar emrin (ture u nisur nga fjala Kreshmet, kanë farkëtuar fjalën Kreshmëshë), dhe, si çdo gjë që ata kanë marrë hua pa detyrën e kthimit, edhe kreshmeshën e kanë përvetësuar».

Dhe këtu, e me këto fjalë, lalë Fatlumi i dha fund kallëzimit të tij.

E Ënjtja e Madhe kish(te) shkuar.

Atë natë, nga e Prëmtja e Madhe ture u dirë e Shtuna e madhe, na fëmijët e gjithë sonë ng' kemi mbullitur sytë fare. Prisjim me padurim të madh të zbardhni e Shtuna e Madhe se të dijmë cilin prej nesh, zonja Amise, guraja e lalë Fatlumit, do të zgjidhni për të helqur pendën e fundit e t'e (ta) digjni në zjarrë bashkë me kukullen. Tradita parashikoni, mes të tjerash, se një fëmijë i vogël i familjes gëzoni të drejtën e helqjes dhe e djegies së pendës fundore, sepse ai, me moshën e tij të njomë, simbolizoni çeljen e jëtës së re në botë.

Lalë Fatlumi me zonjën Amise, fatëkeqësisht, ng' kishin pasur bijë.

Shumë gjëra si kjo (Kreshmesha, gjuha, prejardhja, riti, lash-tësia, klasicizmi...) në rininë tonë, kanë qenë simbolet e mitet në të cilat brezi ynë, e këtu kam fjalën për ata që sot kanë kaluar të pesëdhjetat, ka besuar dhe ka marrë frymëzim për të krijuar një ideal jete.

Sot? Sot, po ashtu si dje. Vetëm kanë ndërruar pikat e referimit nga të cilat rinia frymëzohet.

---

(1) Kah; (2) duke zbritur; (3) rrugicë; (4) gomar; (5) rrezet; (6) që kapton; (7) kukulle; (8) shtalka; (9) dhomës; (10) lebetitur; (11) duke lexuar; (12) mungonin; (13) prishej; (14) cepikë; (15) shkonim; (16) dy ditë "të marra hua" nga tradita latine që i shtoheshin të Lidhurave; (17) llupsi; (18) gdhirë; (19) i ngrirë; (20) shpunë; (20) nxitimthi; (22) dëshmitarët; (23) hamës; (24) gëlonin; (25) gumëzhinte; (26) hoje; (27) pushtuar; (28) mëngjesi; (29) kollapit; (30) i buhavitur; (31) gajde; (32) pluhuri; (33) lashë; (34) vdekja; (35) pastërma; (36) deri; (37) shndritnin; (38) ferri; (39) soli; (40) përket; (41) italiane;



## Llafkrat.

*«Ng' jemi më se tre o katër,  
jemi aq sa mban një vatër.  
Dhe po vimi pjot hir,  
hapna derën ti zonja e mirë!»*

Si iu përgjegjëm, me këtë vjersh shumë të përhapur asi moti (1) në katundin tonë, zonjës Amise që nga lart, si na njohu, na pyeiti sa vetë ishim, hytëm mbrënda pullasit (2) të Llafkravet atë mbasditje të ftohtë shëndreu (3).

Në të hyrë, si shkonje prakun e derës, në anën e djathtë, menjëherë nisej një shkallë e shtruar me gurë Llongu (4): gurë që bijin në një të gjelbër të errët e që aty-këtu ende ruajin një shkëlqim të moçëm dhe pak si të fishqur. Muret e zbardhura me këlqere, shtojin dritën e pakët që hyni nga dritësorja, e cila krijoni, këtukëtje, figura-hje që lëvizjin e, herë-herë, çeljin tek ne fëmijë trëmbje nga ato që rrjidhjin nga motra të lashta. Kjo shkallë, mbas disa zdridhje, të qellni (5), siç të qellën ehde sot e kësaj ditje, drejt tek



një mbalatur (6) ku hapeshin dyert e dhomavet të shpisë. Shumë histori si kjo kam jetuar kur kam qënë piçrupiq (7) fare, dhe nani që shkruanj, të gjitha, me vrull, më fularen (8) ndër mend. Shof me sytë e kujtimit, aty, tek ky mbalatur, Vjollletën. Një qen i butë, i qetë, me lëkurën në një të kuqe të errët dhe të zezë, që të kujton lulet e egra që çeljnë muajin e marsit ndër shkëmbinjte e katundit tonë, e që ne, fëmijë, mbjidhjim për t'ia falur Krishtit në varr të Prëmtën e Madhe. Aty, rrini Vjollleta me ditë të tëra, shtruar përdhe, pa lëvizur e pa lehur fare, ture mos çarë fare kocën ndo për bukë, ndo për ujë; mirrni të ngrënë të vetëm ka duart e zonjës së saj, të cilën ajo ruani ditë e natë, dhe e qetësoni nga trëmbjet e shumta e të moçme që, bashkë me pajën e nusërisë, kish sjelë nga katundi i saj çëkur, nuse e re, kish hyrë në shpinë e Llafkravet.

Gjatë jetës së tij, shumë qen ka pasur dhe ka rritur lalë Fatlumi, dhe të gjithë kanë qënë të djallëzuar, veç Vjollleta. Ky qen kish një sjellje të rrallë, aq sa ng'kish të rrëfyer, dhe gjindjes së shpisë, sa më shkoni moti, aq më shumë i mbjohej (9) mendja se ky qen ng'ish gjë tjetër veçse një Orë Dheu.

Me javë e me muaj të gjithë Llafkrat, pjeq e të rinj, lostën (10) trutë ture rëmuar ndër kujtimet e tyre, ture kërkuar ndër sënduqet, aty ku ruheshin kartat e vjetra, të cilat bëjin fjalë dhe dëshmojin për shpinë dhe origjinën e saj të lashtë, për të gjetur e ditur se kush ka qënë kjo grua shpirtmirë që, simbas traditës dhe besimeve popullore dhe gjysmë pagane, u kish rikurmëzuar në kurmin e Vjollletës, dhe nani në të jetoni.

Shkojin muajt, rrigulliseshim javët, dhe një ditë të bukur, noitëshës (11) së Llafkravet, zonjës Rinë iu dheks (12) të hapni Trisain. Ish ky libri i të vdekurvet ku, veç lutjevet të përsipirtshme, ishin edhe të shkruar të gjithë emrat e gjindjes së kësaj familje që kish ndërruar jetë gjatë shekujvet, dhe shënimet në të niseshin nga

motrat më të lashta të katundit tonë. Zonja Rinë, pra, pjaka e shpisë, jo vetëm se shkruani në Trisain, por edhe e mirr me të çdo herë që veni në qishë dhe, gjatë meshës, diovasni (13) emrat aty të shkruar dhe i lutej Zoti ture i kërkuar lipisi e ndjesë për shpirtrat e të vdekurvet të saj. Rrallëherë ajo diovasni faqet e para të Trisait; aty gjëndeshin emrat e të vdekurvet të moçëm, që nga shumë mot kishin hyrë në harresën e gjindjes.

Mirëpo, një ditë, ndryshe nga herët e tjera, zonja Rinë zu të diovasni dhja (14) faqet e para të Trisait. Një, dy, tre... faqja e katërt ish disi pak e rëndë: ajo u kish ngjitur me të pestën. Pjaka e Llafkravet, atëherë, nisi me shumë durim t'i shqitni ato ture pasur kujdes të madh mos t'i griseshin e shqireshin e, si ia duall ndanë shqitjes, diovasi... Fërkoji sytë, diovasi edhe një herë tjetër... Ng' mund t'e kish besë... U qas më afër dritsores, ajo ish e zgardallisur dhe drita e diellit hyni e shumtë, diovasi prapë dhe patakxi (15): «Si është e mundur, si ndodhi!...», belbezoi në kocën e saj.

Mbi atë faqe, e katërta pra, të Trisait, që fati, ture e ngjitur me të pestën, e kish mbajtur fshehur për shumë mot, ish shkruar emri i një gruaje: "Vjollcë". Vjollca, një pjestare e moçme të familjes së Llafkravet, një nga strananat (16) e kësaj shpije. Aty, mbi faqen e Trisait, ish shkruar vetëm emri, faregjë tjetër: ndo kazatë (17), ndo ditëlerje, ndo ditëkurorëzimi, ndo ditëvdekjeje... Të gjithë Llafkrat, si muartën vesh të renë e ditës, thanë:

«Ja, gruaja shpirtmirë që nani e rimishëruar rron në kurmin e Vjollletës; ja, Ora e Dheut që i jep zëmër dhe ruan nusen e re të ardhur nga jashtë.»

Misteri i lashtë, lidhur me sjelljen e këtij qeni, më në fund, qe zburthyer, edhe me kaq u qetësua familja e lalë Fatlumit. Nani ditët, javët e muajt zunë prapë të rrjidhjnë ashtu si kishin rrjedhur



më përpara: të sheshta, dhe pa ndonjë bukuri që meriton të vëhet në dukje, dhe të kujtohet.

Qetësia, si të gjitha gjërat e mira, ngë ngjati shumë. Erdh dita, dhe këtu lë t'ju shkojë ndër mend juve, diovasës (18) të dashur, që ka ndodhur në shpinë e Llafkravet, kur pjeqëria shtrëngoi Vjollletën, asaj iu shkurtuan ditët dhe spovisi (19). E tërë shpia ra mbë lip (20), gjithashtu ra mbë lip e githë gjitonia. Të qarat, dhe vajtimet për ditë të tëra tundtën dhe shkundtën jo vetëm pullasin e Llafkravet por edhe shpitë rreth e rrotull tij.

Nani që po shkruanj, shumë ujë ka rrjedhur nga ato ditë, dhe moti dihet se shëron qagat (21), edhe ato nga më të rëndat. Por, në qoftë se sot i zëni fill historinë e Vjollletës Kellinës, nani grua pjakë, ng' thom se ajo do t'i jap prapë vajtimet, por të paktën do t'i njomen sytë. Ahina, Kellina, kur ndodhi historia e sipërthënë, ish vajzë e re, e rritur në gjirin e kësaj familjeje. Më kujtohet, sikur të ish sot, ajo ditë prilli të ftohtë të vitit nje mijë e nëntëqind e...ca, që bashkë me Sepën e Separuqvet shkoni në qishë për të kurorëzuar ëndrrën e rinisë...

Po, më falni zotëri, ku e kisha lënë rrëfimin?... O Zot!... Bora fillin, dhe humba fare ndër kujtimet. Ju kërkonj ndjesë! Me sa shof, më ka zënë pjeqëria edhe mua.

Ja, ku kishim mbetur, tek mbalaturi.

Në të djathtë, si sosën shkalla, gjëndet, ndër të tjerat, edhe dera e dhomës së zjarrit. Aty mbrënda hytëm na të gjithë. Një vatër e madhe dhe e zezë zëni pjesën e fundit të dhomës, ku, nën një krahë dru shparri, zjarri kish zënë të ngjallej. Vambat (22) e djallëzuara kërkojin të hapjin udhë anamesa (23) gobaçevet që kërsisjin, dhe, si diljin jashtë, të gjalla, të lira dhe të hjeshme (24) lartësoeshin si gjuhë të kuqe dragonjsh ture lëpirë llunazat e zeza të kamas-trës. Zonja Amise ish ulur në të djathtë, dhe, ndërsa i hidh një sy

poçes pranë zjarrit ku zieni një grusht fasule, ndreqni e bëni gati një hijlnar (25) të vjetër. Këtu, ng' duhet të harromi se asi moti, gjatë dimrit, në katundin tonë të shkretë, sosni (26) një përmjerrje harabeli më shumë dhe drita elektrike pritej, dhe, shumë herë, ndodhni se qëndrojm pa dritë fare ditë e netë të tëra. Kështu se, tash sa mot, çdo mbasditje dimri, ish bërë zakon se para të kumbisej dielli prapa malit dhe të bini nata e parë, zonja Amise mirrej me ndërtimin e hilnarit të saj, qoftë edhe për të larguar sa më shumë ato trëmbje për të cilat bëmë fjalë më sipër.

Me të vërtetë, ky hilnar ish i bukur shumë, o të paktën kështu na dukej neve fëmijë. I lartë, me tri drita, bëni ninëzën nën duart e saj. Lëvizje të masura: pastrimi, tjerria e mbumbakut (27), dredhja e miçit (28), hedja e valit, vendosja në vendin më të mirë të dhomës së zjarrit, dhe, në fund fare, dhezja nga duart e saj, si duar të Papadelevet (29) të lashta që ruajin në Tempull Zjarrin e shënjtë; ishin këto rituale që përsëriteshin nga dita. Dhe, ture u përsëritur çdo ditë, dhe për shumë vitra, ka zëmra e zonjës Amise çeli një poezi. Dua këtu t'i kujtonj fjalët, të cilat asi moti më kanë fatosur: «Kam një hilnar të vjetër shumë / që mban mend disa gjeneracionë / kur drita shufet e u jam vet(ëm), / si kriatur trëmbem vërtet. / Kur ikin drita e vetëm qëndronj, / marr atë hilnar dhe e ndërtonj, / i vë miçin me mbumbakun / e valtë, ia shtie pak e pak. / Duket se më bën kumbanji / ime vjefërr që afër më rri: / më duket së më ruan, / më duket se më fjet, / e nëng trëmbem më se jam vet(ëm). / Hilnar i bukur, u mirë të dua, / e të dishëronj përherë me mua, / pse më kujton gjindjen që gjeta, / kur tek kjo shpi erdha e mbeta.»

Lalë Fatlumi, që ndodhej aty, ulur ka ana tjetër e vatrës, si gjegji poezinë e së shoqes, - e kish gjegjur edhe shumë herë të tjera, me të vërtetë -, mbulliti librin e vjetër që po diovasni, vu buzën në



gaz e na shkeli synë. Me atë shkelje syu desh të na thoni se poezia që kish bënë gruaja e tij ng' kish vlere fare.

Sillej kështu, lalë Fatlumi, gati me të gjithë shkrimtarët dhe vjershetarët që lulëzojnë atë mot, dhe që mbjojnë me veprat e tyre faqet e gazetave që diljin dhe qarkullojnë në Arbërinë tonë. Duhet të dihet se Lalë Fatlumi, sa për të shara, qeshje nën musteqevet dhe shkelje sysh ng'ish dorështrënguar. Iu kish mbjuar koca se ture qënë ai një "i vetxënur", o si i pëlqeni atij të thërritej "një autodi-dat", ish sipër të gjithëve; thoni se kish bënë studime të thella rreth gjuhës, kështu se vjershi i tij ish më i hulluar, më i kulluar, më i hjeshtëm, më i rrjedhshëm, më i bukur... Shkurt, më i dijtur. Mirë, kur burri i dheut, me mendimet dhe bindjet e veta, dëm ng'i bën njeriu, le të fryhet si do; neve, kjo anë e shpirtit të tij, ngë na shkundni fare. Për të, dhe për të gjithë familjen e tij, nderi ynë ish i madh, dashuria për atë shpi kish rrënjë të thella në zëmrat tona. Ngaherë i vejim në shpi me hare të madhe, me etje të madhe për të gjegjur historitë e moçme, për t'u bëgatur me rrëfimet e tij.

Atë mbasditje shëndreu, na, ulur e shtruar rreth vatrës ku kërsitni zjarri, dhe poçja gati po përfundoni zierjen e fasulevet, merra e të cilavet kish mbjuar dhomën e zjarrit, ture skroqollisur (30) ndonjë kështënjë të pjekur, ndërsa kumbora e orëvet bini e ngjurrët (31) ture lajmëruar orët, dhe me atë tringuli disi të rrallë paralajmëroni gjithashtu edhe ndonjë borë në të ardhmen e afërt, i pyejtëm lalë Fatlumi se ç' ish ture diovasur në atë libër që pak më parë mbani hapur përpara syvet.

Ng'ish hera e parë që na shifjim atë libër të trashë e të vjetër; dijim shumë mirë se faqet e atij libri mbjidhjin shkrimet e zotit lalë, don Erokut, arbëreshologut, stratatmadhit (32) të lalë Fatlumi. Aty, sipër atyre faqeve nani të zverdhura e të vjetruara nga vitrat, ishin shkruar përfundimet e studimeve të tij rreth gjuhës,

kulturës, traditës... arbëreshe, kështu se pyejtja jonë i ra ndër vesh lalë Fatlumi disi pak retorike, dhe përgjegjia erdh me pak përtesë. Me të vërtetë, ai ish ture diovasur atë pjesë të librit me studime gjuhësore me titull "Fjalë të mbrazëta". Ishin aty, të grumbulluara e të shpjeguara, të gjitha fjalët e gjuhës arbëreshe të katundit tonë të cilavet u kish mbetur – këtu të bëmi tonën shprehjen e Nandinit të Helmëravet – vetëm kariqja (l'involucro), kurse vjenmethënia e tyre kish humbur gjatë udhës së historisë arbëreshe.

Me kaq sa u tha njera këtu sipër, të dashur diovasës, shifet hapur se problemi i së folmes arbëreshe – këtu të mos harromi se don Eroku ka vdekur rreth vitit 1850 – të humbjes së fjalëvevet, të humbjes së vjenmethënievet, të shtrëmbërimevet... është problem shumë i vjetër, ka nisur që në lashtësinë e motravevet dhe po ecën përpara. Problem ky që patjetër do të frymëzojë ndonjë rrëfim tjetër.

Ndërkohë nata kish rarë. Zjarrit kish zënë t'i bini fuqia, vambat me shkëlqimin e tyre kishin mbetur vetëm një ëndërr. Tigani rrini aty, pranë vatrës, pjot me skroqollat e kështënjavet, dhe gjumi zëni e dukej me të hapura grykje pakund. Na, të gëzuar, dhamë natën e mirë njëri me tjetrin dhe u ngremë, ndërsa kumbora e orëvet, edhe më e ngjurrët se më parë, bini të njëmbëdhjetat. Të lumtur nga shpresa se nesër kishim për të gjetur katundin të zbardhur nga bora e parë të shëndreut, muartëm udhën e shpisë sonë.

1 Vit, por edhe kohë; 2 Saraj; 3 Dhjetor; 4 Emër vendi (toponim); 5 Të çoni; 6 Kryeshkallë; 7 Çiripup; 8 Vërshojnë; 9 mbushej; 10 Tretën; 11 Zonjë e rëndë, fisnike; 12 Iu tek; 13 Lexoni; 14 Mu, pikërisht; 15 Mahniti; 16 Stërgjyshet; 17 Mbiemër; 18 Lexues; 19 Ngordhi; 20 Në të zi; 21 Plagët; 22 Flakët; 23 Midis;



24 Të hijshme; 25 Bishtuk; 26 Mjaftonte; 27 Pambuk; 28 Fitol; 29 Priftëreshave;  
30 Shkokëluar; 31 Ngjirur; 32 Stërgjyshi.

## MOSNJERIU (1)

«... Të pavdekshmevet Perëndi u truhën këta:  
Degë ng' mbielljnë, farë ng' hedhjnë  
Mbi dhë që pramenda kurrë ng' çajti e,  
Pa mbjelë faregjë, pë çudi,  
Gjithë e mira lulëzon vetë:  
Grurët, thekra, e këndmja vreshtë  
Që atje mbjohet me veshë (2) të mëdhenj,  
Të ëmbël e mbi të cilën Zeusi  
Shiun qiellor derdhën»

(Odiseja, kënga 9<sup>o</sup>)

Katundin e vogël arbëresh, me udhë të ngushta e të shtruara me gurë lumi, të cilat gjalpërojnë ku ture u hipur, ku ture u hjimisur (3) përpara brinjave e shesheve që daljnë papritur e pandërprerje anamesa (4) shpivët të ulta e të karrambulljasura (5) njëra sipër tjetrës, e përvëlioni vapa e gushtit.

Një mbasditje asosh, të atij moti, kur dielli, i lodhët pas një ditje të gjatë, ende ng' kish shkuar të prëhej prapa malit, por vetëm dridhej i verdhë mbi kurrizin e Mulës (6), dhe me rrezet e tij ende përvëluese arisni qaramidhet e shpivët si edhe të gjitha gjërat që ndodheshin aty rreth e rrotull, na, corrobijtë (7) e gjitonisë Bregu,



thamë se do të ish gjë e mirë, meqë kish shumë ditë që ngë shi-heshim me lalë Fatlumin, t'i shkojmë në shpi.

Është e ditur se të rinjtë shurbiset (8) i bëjnë mënjëhere se t'i thonë. Kështu, me një të hapur e të mbullitur sysh, të githë se ç'ishim u gjëndtëm përpara pullasit (9) të Llafkravet, gati të troku-llojmë (10) në derën e shpisë gjymsë të hapur.

Mbani kurmin drejt, leshtë pak në të verdhë, me aty-këtu disa qime të bardha si të argjendta, të pjeksur e të mbjedhur prapa xerkut (11) që i hijesoni çerën (12), atë çerë që buthtoni se të pesë-dhjetat me mot kishin shkuar, zonja Amise, gruaja e lalë Fatlumi, kur atë mbasditje, na ka pritur krahehapur si ngaherë. Me një buzë-qeshje të ndritshme, na zgardallisi (13) derën ture na thënë:

- Mirë se erdhët, bij! hyni mbrënda.

- Mirë se ju gjetëm! Lalë Fatlumin në shpi e kemi?

- Në shpi, në shpi është. Ka pak që u mbjodh ka Shkunata (14), e nani (15) po prëhet ture diovasur (16). Vitrat i ka, i bekuari, dhe niset e vjen nga vreshta më këmbë, me dy panare (17) pjot me fiq. Nani, të likosur (18), e gjëni ulur tek terraca e Nespulës (19), dhe, meqë udhën e njihni mirë, ju lutëm të shkoni vetë.

Me këto fjalë, zonja Amise mbulliti derën, dhe u largua.

Pullasi i Llafkrave kish shumë shurbise të rralla e me ëmra të çuditshëm: "Terraca e Nespulës", "Terraca e Diellit", "Oda e Librevet", "Oda e Mirë", "Oda e miut", e të tjera si këto; të gjitha tregojin lashtësinë e kësaj shpije.

Hymi. Djathtas, këcemi prakun e derës e gjëndemi në një gjymserrësirë. Ish ajo një odë e vogël, e xheshur (20), ku, në fund të saj, dikur, një mjeshtër shumë i rrallë pat(i) ndërtuar me dru arrje një shkallë të bukur fortë. Në atë odë, ku rregjëroni (21) një qetësi e madhe, gati-gati e shënjtë, shkalla ngjitej ture u zdredhur rreth

boshtit të vet si një turjel, dhe na, pas saj, zdridheshim ture shkuar sipër, ku na prit Oda e Librevet.

Një odë kjo aq e gjerë sa e gjatë. Dy muret e saj, njëri përballë tjetrit dhe anësorë murit ku ish dera e hyrjes, ishin tërë të mbuluara me dy libreri pjot libre; murin, të cilit i prirje (22) krahet sapo hyje, e pushtrojin diploma, dëftesa, fotografi, pergamena të ndryshme, dhe sipër ëndit (23) të derës së hyrjes, ish varur ritrati me ngjyra vaji i një burri mbi të gjashtëdhjetat. E kishin zografisur me cinura (24) të ngrehura e të zeza si krahe shqiponje, me lesh të bardhë e qimerrallë, me dy musteqe të mëdha, pak si të verdha e të përdredhura që i diljin jashtë faqevet dhe i gjithë i veshur me të zeza. Rrini më këmbë stërtatmadhi (25), dhe, me sy të vrërë, ruani me rreptësi, nga sipër ëndit të derës, atë që hyni në Odën e Librevet ture i kallur, të mjerit, një lemeri të parrëfyeshme. Disa tryeza të madhësive të ndryshme, të pjuhurosura, pjot karta të verdha, penda e libre, zëjin truallin. Tek muri, i cili ndodhej përballë hyrjes, hapej një derë e madhe, me anë të së cilës dilej tek Terraca e Nespulës, ku, atë mbasditje gushti, po prëhej lalë Fatlumi, ture diovasur një libër të vjetër.

- Mirëmbërëma, lalë Fatlu! si jeni me shëndet? Zotrote, ç' diovasni në atë libër aq të vjetër? – thamë, na, ture dalë tek terraca.

- Mirë se erdhët, bij! Uluni këtu, njëri pranë tjetrit, përposh hjesë (26) së nespulës, sepse rrezet e diellit të këtij fund gushti janë ende përvëluese. Ja, po prëhem, more bij. – Vazhdoi lalë Fatlumi – U mbjaka, dhe rronj me kujtimet e motit që shkoi. Diovasënj histori të vjetra, shumë më të moçme se u(në). - Dhe, me këto fjalë, lalë Fatlumi mbulliti librin, ture ngulur mbrënda gjishtin e dytë të dorës së djathtë për të mbajtur mend faqen ku kish qëndruar së djovasuri, dhe, si ndreqi shapkën (ky i shapkës, ish një ritual që



përseritej ngaherë, edhe kur diell ng' kish), aq sa të pengoni diellin mos t'i bini ndër sy, vijoi së rrëfyeri:

- Këtë libër kaq të vjetër, si mund të shifni edhe ju, bij të dashur, e ka shkruar ndjespasti zoti lalë, don Eroku rreth vitit 1820, dhe mban titullin: "Rrëfime të moçme arbërisht".

- Më falni, lalë Fatlu – i preu fjalën njëri ndër na – ky don Eroku, që ju po na thoni, mos është ai korb me cinura të ngrhura e të zeza si krahë shqiponje, ritrati i të cilit ndodhet varur sipër derës tek Oda e Librevet?

Të gjithë na qeshtëm, nga fjalët e pavend të shokut tonë, ndërsa lalë Fatlumi pa vënë shumë në kufi (27) fjalën "korb" dhe të qeshurat, vijoi ture rrëfyer.

- Po, ritrati i tij, ritrati i don Erokut, ritrati i zotit lalë. Dhe jo i "korbit", si një ndër ju, me përqeshje, i ka thërritur. Është ai, ritrati që ju keni parë kur keni hyrë në Odën e Libreve.

Shoku ynë, me faqet e trandofilta nga turpi, u anangas (28) t'i kërkoni ndjesë lalë Fatlumi.

- Më falni, lalë Fatlu. Kur e kam parë atë burrë ne atë ritrat, më ka rrëmbyer e më ka shtrënguar lemeria. Kimeni (29) besë, me të vërtetë u trëmbe.

- E mirë, shkoi e vate. Ti, me sa duket, trëmbe me shumë pak, megjithatë, të ndjej me zëmër.

- Lipset të dihet, - zu fill prapë të rrëfyeni lalë Fatlumi – të dashur bij, se zoti lalë ka qënë kanxhulier (30) gjykatorje dhe arbëresholog nga më të mirët, për mos të thom më i miri që ka pasur Bota e Arbrit njera sot. Ky libër i vjetër, me rreth gjashtëqind faqe, që ju shifni, është martri (31) e gjallë të jetës së tij, si studiuës dhe njohës i moçëm të Gjuhës Arbëreshe. Histori, legjenda, kangjele, kënga, graxeta (32), vjershe, kocëkazele (33), ëmre vendesh;

ëmre njerëzish, e të tjera, të gjitha i ka mbjedhur nga goja e popullit, e i ka shkruar me dorën e vet sipër këto faqe. Po ashtu, në të gjënden edhe pjesë të zgjedhura nga klasikët grekë dhe latinë: pjesë nga Odiseja, Iliada, Eneida, e të tjera, që zoti lalë ka pjerrë (34) në gjuhën arbëreshe. Shkurt, kjo odë, për sa ka qënë në jetë zoti lalë, që djepi i gjuhës dhe forxha (35) ku u ehjen (36) fjalët e gjuhës arbëreshe, dhe u(në), për nder të këtij burri, njera sa Zoti të më falë dritën e syvet, do t'e (37) ruanj ashtu si ai e ka lënë, pa hequr gjë, dhe pa shtuar gjë tjetër.

Na, të magjepsur nga fjalët e lalë Fatlumi, rrijim pa lëvizur fare e gojëhapur. Kushedi, prisjim që të ndodhni ndonjë gjë. Dhe na shkundi nga kjo mbitje (38), në të cilën kishim rarë, zëri i zonjës Amisë e cila erdh me një spazë (39) me qelqe pjot me ujë të ftohtë e merikot (40).

Të lumtur, ture pirë pijën e ftohtë, i kërkua lalë Fatlumi të na kallëzoni rrëfimin ç' po diovasni, kur kemi hyrë na.

- Isha ture diovasur, more bij, një pjesë nga Odiseja e Homerit, pikërisht këngën e nëntë, të cilën ndjespasti zoti lalë e ka pjerrë nga greqishtja e vjetër në gjuhën arbëreshe, dhe, gjithashtu, nga poezia në prozë; në këtë këngë përshkruhet përpyekja e Odiseut me çiklopin Polifem.

- Uh, sa bukur! Pse zotrote ng' na e diovasin me zë të lartë, kështu se edhe ne të harepsemi (41) me bëmat e Odiseut?

- Pse jo. Atëherë, pa u varesur (42) gjatë diovasjes, mirrni vesh mirë. – Dhe me tingull kumbues, nisi diovasjen lalë Fatlumi.

"Kur ia errum (43) dheut që na dilni përpara, pamë, në pjesën më të sprasme të tij, dhja (44) afër detit, një shpellë të madhe tërë e mbuluar me degë dhafnash. Atje kishin zakon të shkojin natën mëndrat e dhive e të dheneve. Rreth oborrit lartësohej një mur i madh guri nën hjenë (45) e pishave të mëdha e lisëve degëgjërë e



fjetullorë (46). Në atë vend kish shpinë një short xhagandi (47), i cili rroni i vetmuar, kullotni mëndrat, dhe ng' doni të sihni njeri me sy. Ngaherë bjuani në trutë e vet të zeza e fatkeqësi. Ng' kish ngjasje (48) me njeriun që mëkohet me bukë, por më shumë ish si një çukë mali që, sipër tjerash, ngrëhet vetmitare.

U thom shokëve të ruajnë anijen, dhe nisem bashkë me njëzet nga ata që kisha zgjedhur ndër më të fortit. Mora me mua një rrëshiq dhije pjot me verë të kuqe dhe shumë të ëmbël. M'e kish dhënë, këtë verë, Maroni i Evantit, prifti i Apolonit, i cili është zoti mbrojtës i Ismarës, për arsyjen që bashkë me familjen e vet ng'e cënuam fare, dhe shpinë, që e ka në mes të dushkut të Febit Apolon, ia ruajtëm. Edhe të tjera dhurata të shtrënhta më bëri: shtatë talenta (49) ari, një kupë argjendi, dhe pjot dymbëdhjetë anfora (50) me verë shumë të ëmbël. Kjo verë, me të vërtetë, ish një pije zotash, dhe mosnjeri i shpisë dini se ku ish fshehur, veç ai, e shoqja dhe shërbëtorja. Nga kjo verë-nektar që të bësh një verë të pijshme duhet të përziësh çdo kupë me këso verje me njëzet kupa me ujë. Me këtë verë mbjova rrëshiqin, dhe të ngrëna të ndryshme mora pjot një trastë; më thoi koca (51), se do të përpiqeshim me një xhagand shpirtgër.

Tek shpella ngë gjetëm njeri, çiklopi kish dalë të kullotni dhentë e tij të majme.

Mbrënda shpellës, ruajim (52) me çudi çdo gjë. Dërrasat pjot tiravole (53) me djathë, gardhet me shtjerra e kaciqra (54) të ndarë sipas moshës. Hirra, ajka e qumështi derdheshin nga kakovët, karroqet e govatat, mjeshtërisht të punuara druri. Atëherë, shokët m'u lutën të mirrjim sa më shumë asi djathi, kaciqra e shtjerra dhe të hjimiseshim (55) ka po na prit anija. Atyre, për fatkeqësinë tonë, ng'u mora vesh. Ngë më shkoni ndër mend se njohja me çiklopin shumë dëme do të na sillni mua e shokëve të mi.

Dheztëm zjarr, bëmë therore, dhe u dëfryem. Kështu po prisjim ardhjen e zotit të shpisë.

Mbas pak, erdh. Mbani sipër krahëvet një barrë dru të thata, dhe kur e hodhi përdhe shkakttoi aq një gjëmim sa na, të trëmbur, u ngultëm ndër vërat (56) dhe zgarbullat më të errta të shpellës. Këllau, pëstaj, përmbrenda shpellës delet e majme, gjithë ato që milni, kurse cjeptë e deshtë i la përjashta, në oborr. Me një shkëmb, që me duar ngrëjti, zu hyrjen e shpellës. Aq i madh e i rëndë ish guri, sa ng'e tundjin nga vendi as njëzet e dy qerre katerrotash. Si mbulliti hyrjen e shpellës, zu të milni të gjitha delet e me radhë dhitë blegëruese, dhe secilës, mbas mjeljes, i afroni tek gjiri shtjerrin ose kaciqin. Fill pas, gjymsën e qumështit e piksi (57), dhe me gjymsën tjetër mbjoi ca karroqe që t'e pini kur të dëshroni, si edhe t'e përdorni në vend të verës, ose të ujit, kur të ulej të hani bukën. Si u dha fund punëve të shpisë, dhe ndërsa po dhezni zjarrin, na zbuloi, dhe zu të na pyeni: «O të huaj! Kush jini ju? Cila stuvalë deti ju paska shtunë ndër këto brigje tona? Ndoshta kini ndonjë punë? Ose xarriseni (58) si kusarë nëpër dete ture rrizikuar kocën për të zezën e të tjerëve?» kështu fjit, dhe neve ai zë shpellor dhe ajo çerë e shëmtuar na lanë të marmarostë (59). Megjithëkëtë, zura dhe i fola: «Na Akej jemi, dhe vimi nga Troja. Mundohemi të priremi (60) ndër brigjet tona të shtrënhta, por larg na mbrapsi, mbi greminën e detit, vrulli i erëravet. Këtu kemi rënë padashur sepse kështu ka dashur i madhi Zeus. Jemi luftëtarë dhe krenarë se ndoqtëm, si trima, Atrid Agamenonin, zëri i të cilit aq fort kumbon nën qiellvet të lartë, sa i madh dhe i shkëlqyer ish qyteti që ai rrënoi, dhe të panumërt kanë qënë popujt që u zhduku farën. Sonte, si miq na tek ti erdhëm, të na presësh, si pritet gjindja. Ki nderim, o guximtar, për Zotat, dhe mos harro se Zeusi hakmerret rëndë për miq e se Derëhapuri do që miqve t'u shtrohet tryesa».



Zëmrkeqi kështu m'u përgjegj: «Vërtet fëmijë je ti, or i huaj, o vjen nga larg. Si të trëmbem e të nderonj Zotat? Vëre ndë kocët se na, çiklopët, ngë dimi se ç'është frika për Zotat, ose për vetë Zeusin, sepse shumë më të fortë jemi na se ata, jetët tuaja, t'e dish, varen vetëm nga u(në). Po thuanë, dua vetëm t'e di, ku e ke lënë anijen?» Kështu fjit, i pashpirti, ture më spërvuar (61). U kuptova qëllimin e tij, prandaj iu përgjegja: «Anijen m'e (62) çajti Poseidoni Enosixheu (lëkundësi i dheut) ture e rrahur nëpër shkëmbinjtë e bregut këtu afër, vetëm na kemi shpëtuar».

Kështu fola, dhe ai pa m'u përgjegjur u hodh mbi shokët, dhe me duar rrëmbei dy fatshkretë. Si dy kulish i hodhi përdhe. Trutë e të mjerëve kullojin poshtë dhe lag'jin truallin. I bëri copa copa, e me atë mish shtroi darkën, dhe, si luan malesh, zu të hani, pa lënë gjë t'i shkoni dëm.

Na, me lot ndër sy, ngrëjtëm duart ka qielli, e lutëm Zeusin. Kur e mbjoi barkun, u shtrua për trualli, atje në mes të dhenve. U, nga ana ime, mendoja t'i hidhesha përsipër, e me shpatën t'i shpoja barkun. Por frika se mund të qëndrojm të varrosur mbrënda shpelles, ngaqë s'kish burrë me aq fuqi sa të hilqë atë gurin e madh që çiklopi kish vënë tek hyrja e shpellës, më preu vrullin. Kështu, ture vajtuar, pritëm që të zbardhni dita e re.

Sapo çeli agimi, çiklopi dhezi zjarrin, prapë nisi mjeljen e mëndrës, dhe si u dha fund punëve të shpisë, prapë zu dy nga shokët e mi, dhe me mishtë e tyre, hëngri hudhrën (63). Holqi, pëstaj, shkëmbin ka dera, dhe, si dual jashtë bashkë me mëndrën, e rivendosi atë, ture mbullitur mirë derën e shpellës. Ture thërritur e fërshëlyer, ka mali zu të rëzoni dhentë e veta. Ndërsa u, i pikëlluar, dhe me përkrahjen e Athenasë, mendoja ndonjë rrugë-dalje.

Çiklopi kish lënë, aty pranë, një kurm të trashë dhe të gjelbër ulliri, me të cilin, sapo të thahej, do të bëni një shkop. Aq i madh ish ai kurm ulliri sa, neve, na dukej direku (albero di maestra) i një anije njëzet rremash. Nga ky kurm preva një pjesë, dhe shokët i vura t'e qërojin mirë, ndërsa u ia mpreha dhe ia përsëllova çukën; kur puna sosi, atë hu e fsheha mirë nën kopresë (64). Këshillova shokët të shtijin tokun (65). Doja që fati të caktoni katër prej tyre, të cilët bashkë me mua t'i nguljim e t'i përdridhjm atë hu ulliri mbrënda kakërdhokut të syut të çiklopit kur ai të bini në gjumë. Shokët që u dëshroja, toku caktoi. Katër burra të fortë, dhe u i pesti.

Kish rarë muzgu kur, nga kullotat malore, u pruar çiklopi me dhentë leshbuta. Këtë herë, këllau mbrënda tërë mëndrën, pa lënë asnjë krerë përjashta shpellës. Pëstaj, mbulliti hyrjen e shpellës me të madhin shkëmb, dhe, ulur pranë vaut, zu të milni delet dhe dhitë e tij blegëruese. Secilës dele e dhi, pas mjeljes, i afroni tek gjiri shtjerrin o kaciqin. Si mbaroi këto punë, u nguli thonjtë, edhe një herë, dy shokëve të tjerë, e me kurmet e tyre darkoi.

Atëherë, iu qasa, mbaja ndër duar një kupë pjot me verë të papërzier, dhe i fola: «Pije këtë kupë me verë, mbasi ke ngrënë mish njeriu. T'e kisha sjelë, këtë verë, sa për mirëgjetje, por ti na u kallëzove i pashpirt». Ai muar kupën nga dora ime, dhe piu verën. Më kërkoi që t'ia mbioja prapë kupën: «Mbjome edhe një herë kupën, dhe më kallëzo emrin tënd. Dhurata të mira kam për të të dhënë, për besë!. Ky dhë që ti shef, e që me shirat e potisin (66) i madhi Zeus, çiklopëve u jep verë shumë të mirë, por jo si kjo jotja. Me të vërtetë, kjo jo ambrozë, por nektar është».

Tri herë ia mbjova kupën me aso verje të trashë, e tri herë, marrëzisht, skulloi (67) kupën. Sapo vera nisi t'i zëni kryet, ëmbël-sisht i fola: «O çiklop, më kërkon emrin, u t'e thom, por mbaje



fjalën e dhënë! Mosnjeri është ëmri im. Mosnjeri të gjithë më thërresjnë, mëma, tata, shokë e miq». Kështu i fola shpirtkeqit, e ja si m' u përgjegj: «"Mosnjeriun" do t' e ha për së fundi, mbas që kam ngrënë të gjithë shokët e tij, ngë kam dhuratë më të mirë që t' i jap».

Me kaq, ra përdhe. Një gjumë i rëndë e pustroi (68) menjëherë.

Bëni një gjumë shumë të trazuar, grokësini egërsisht, dhe vill ture nxjerrë nga goja mish njeriu dhe verë. Atëherë ngula hunë e ullirit në zjarr sa të nguqej, dhe nisa ture i dhënë zëmër shokëve. Sapo huri zu të dhezej, e holqa nga zjarri, dhe ia afrova çiklopit. Një Zot na dha guxim. Shokët ngrëjtën hunë dhe e ngultën në syun e çiklopit, dhe u ia drodha e përdrodha përmbrenda. Gjaku kulloni rreth e rrotull. Cinurat u përsulluan. Digjej ninëza. Kërsisjin rrënjët e suyt ture u pjekur. Dhe ashtu si kërset hekuri i nguqur kur forxhari (69) e ngulën në ujët e ftohtë, kështu kërset, ture u diganisur syu i çiklopit rreth hurit të dhezur.

Një ulërimë lëshoi, të gjatë, të frikshme, aq sa gjëmoi shpella.

Na, të trëmbur, iktëm me vrap kur ai shkuli ka syu hunë e ndotur dhe e hodhi për trualli. Zu t' u thërritni çiklopëve që banojin aty përreth, nëpër shpella të rrahura nga era. Vijin ata drejt nesh, dhe pyejin përpara hyrjes së shpellës ku na ishim të burgosur: «Çfarë të ka ndodhur, or Polifem, që ture ulëritur në mes të natës na zgjove nga i ëmbli gjumë? Mos ndokush të vodhi mëndrat? Ose një njeri do me forcë, o tradhëtisht të të vrasë?» E, përmbrenda shpellës, përgjegjje Polifemi: «Or miq, Mosnjeriu më cënoi rëndë, me tradhëti e jo me forcë.»

Ata i përgjegjeshin: «Meqenëse mosnjeri ng' të nget, vjenmethënë se të keqen e ke nga Zeusi. Lutju tët eti, Poseidonit rregj.»

Kështu i foltën, dhe të gjithë iktën. U kënaqësja nga e rremja që i kisha tjerre.

Rënkoni çiklopi nga dhëmbja e madhe që i shkaktoni syu i shkatërruar. Dhe ture ecur me këmbë e me duar, iu afrua derës dhe holqi shkëmbin e rëndë që zëni hyrjen e shpellës, dhe aty qëndroi, me duar të ulura, i bindur se do të zëni ndonjerin prej nesh ture dalë. Kaq bab (70) më bëni mua, ai i mjrerri. U mendjen po vrisja ture kërkuar një rrugë për të shpëtuar nga ai rrëzik.

Në fund fare, ja se çfarë mendja më puall. Ishin atje shumë desh të majmë, me lesh durrudhjar (71) e ngjyrë manushaqe. Tre nga tre zura e i lidha me degë shelgu lotues të përdredhua, ndër ato që Polifeni përdorni për shtrat. Deshtë e mesëm në nënbarkun e tyre bartjin shokët, kështu ata do të diljin të fshehur nga dy deshtë e tjerë. Sa për mua, zgjodha më të bukurin e mëndrës. Iu hodha në kurriz, dhe ture shkarë qëndrova përposh barkuk qimedredhur të tij, ture u mbajtur me dy duar. Kështu, ture shërtuar, pritëm agimin. Kur menatet (72) shkrepni agimi me gjishtët e vet të trandofiltë, lëshohen meshkujt e mëndrës ka(h) kullotat, kurse fëmrat blegërojnë mbrënda gardhevet me sisët e pamjela. Shpirtkeqi, i lodhur nga dhëmbjet e forta, ngit me duar kurrizin e meshkujvet, që ture shkuar i qëndrojin përpara tij, dhe fare ng' i shkoni mendja, trudalurit, se shokët e mi, të lidhur përfund barqeve të deshvet, po i ikjin nga duart. Në fund të mëndrës, dilni, dalëngadalë, dashi im. Ish i rënduar nga leshi dhe nga kurmi im.

Ture e ngarë me dorë, Polifemi i foli: «O dash i lumtur, ç' të ka ndodhur sot, që i fundit paske dalë nga e errta shpellë? Zakonisht ke qënë ngaherë i pari në kullota, për rrëpula (73) të njoma, i pari tek rrjedha e lumit, dhe po ashtu i pari burrarnje (74) mbrëmanet për në shpi. Ç' të ndodhi sot? Patjetër që je edhe ti i helmuar nga



fatkeqësia që më ra kalosh (75). Më verboi një njeri i pavlyer, bashkë me shokët e tij, mbas që më dejt.

“Mosnjeriu” qe. Po u të thom që ai, ai Mosnjeriu, ende ng’i shpëtoi vdekjes! Sikur të dinje ti të fjisje, patjetër që do të më kallëzoje vendin ku ai i fshehet tërbimit tim. Do t’i çanja kocën, ture e rrahur ndër muret e shpellës. Vetëm kështu zëmra ime do t’i ndieni më pak vilakosjet (76) që ai Mosnjeriu, burrë i pavlyer, më shkaktoi. Kështu fjit, ndërsa shtyni dashin përjashta shpellës.

Si u larguam nga shpella dhe nga oborri i saj, u(në) u zgjidha i pari, dhe, pëstaj, ndifa të zgjidheshin shokët e mi. Aradhëm (77) deshtë të rënduar nga dhjamët, dhe i qelltëm (78) tek anija. Gëzim të madh shkaktoi takimi me shokët tek bregu. Kishim shpëtuar, por qajim dhe vajtojm për ata të shkretë që ng’ishin më me ne. Shpejt i qetësova, dhe urdhërova të ngrakojin mëndrën në anije, dhe të largojin atë nga limani. Menjëherë, të gjithë zunë vendet e tyre, dhe rrahën lopatat mbi ujërat e kaltra të atij deti shku-mëzor.

Kur qemë larg bregut, aq sa zëri im mund t’i zëni veshët çiklopit, i lëshova një britje shpirtzezit, dhe, ture e përqeshur, i fola: «Or ti, i pasy, ng’ish njeri i pavlyer ai akcili kur erdh si mik në shpellën tënde, e të cilit ti vendose t’i haje shokët. Tjetër vjenmëthënie ka, dhe tjetër sjellje kërkon mikpritja. Prandai, i madhi Zeus të kastjoi (79). Me këto fjalë, ai u tërbua edhe më shumë, shkuli një çukë mali dhe e vërviti me aq fuqi sa ra gati pranë anijes. Tërë deti u trubullua. Stuvalla të mëdha e zhurmuese menjëherë filluan të na shtyjin prapë drejt dheut. Rrëmbeva, atëherë, me duar një purtekë të gjatë, dhe i re ka prapa anijes, ture u thënë shokëve të lëvizjin lopatat me sa më fuqi që të shpëtojm gjallë.

Por kur u ndodhtëm dy herë më larg nga ç’ishim, prapë iu drejtova Polifemit, megjithëse shokët më truheshin të hilqja dorë,

dhe më luteshin: «Më shumë po e tërbon. Ai është gati të na hedhë një tjetër çukë mali, si ajo që për pak ng’na mbyti».

Ng’u mora vesh shokëve. Zura, i zëmëruar, t’i drejtohesha prapë shpirtzezit me sa fuqi kisha: «O çiklop, në qoftë se dikush nga gjindja të pyen se kush të ka vërbuar, përgjegjju: qe Odiseu, biri i Laertit, rrënuesi i Trojës, që ka shpinë në Itaka.» kështu i fola. Atëherë, Polifemi thërriti me të madhe, dhe u përgjegj: «Po vërtetohen, i mjeri u, profecitë. Rroni, dhe u mbjak ndër na Telemi, biri i Eurimit, shortar i zoti, profet i çiklopëve. Ai më pat(i) parashikuar këtë ndodhi. Që u(në) do të vërbohesha nga dora e Odiseut. U prisja që do të vini një burrë i fortë, i bukur, kurse më vërboi një i pavlyer, edhe kur kam qën i dejim. Priru prapë, o Uliks, të presjnë dhuratat e mikpritjes, u do t’i lutëm Enosixheut, zotit që tundin dheun, të të sjellë mbarë udhën e kthimit në Itaka. U i biri tij jam, dhe ai krenohet që më ka bir. Në qoftë se do, është i vetmi që mund të më shërojë, dhe askush tjetër, qoftë zot o njeri.»

Kështu fjit. Dhe u i prora përgjegjje: «Ah, po të mundja, do të të dërmonja fare, dhe të të vërvitnja në të errëten Hade, ashtu si(ç) është e vërtetë se atë syun tënd ng’ mund t’ë shëronjë as vetë Dhetundësi!»

Kështu i the, dhe ai zu t’i lutej Poseidonit: «Gjegjëm lutjen, o Poseidon, dhëndërr i tokës, dhe Zot nga leshtë e kaltër, në qoftë se u yt bir jam, dhe ti im atë, bëj që Odiseu, biri i atij Laertit që banon dhe ka zotërimet në Itaka, të mos priret kurrë më në shpinë e vet. Por në qoftë shkruar që ai të priret në shpi, sadopak të priret vetëm, me anije të huaj, dhe mbas shumë pësime, dhe atje t’ë presjnë fatkeqësi e hidhërimet të tjera.»

Kështu Polifemi lutej. Dhe Leshkaltri ia gjegji uratën.



Prapë, çiklopi rrëmbej një shkëmb edhe më të madh se i pari, dhe e rrigullisi me tërë forcën që pat(i). Ra guri në det, dhja pranë anijes, dhe për pak ng'i çajti timonin.

U tund deti kur në të ra ai short shkëmbi, dhe ngë di si stuvala e madhe ng' na hodhi prapë në breg...»

Me këto fjalë, mbulliti dorëshkrimin e vjetër lalë Fatlumi.

Nata kish zënë të bini sipër shpivet dhe udhëvet të katundit arbëresh. Na u ngremë, të magjepsur nga historia e Mosnjeriut. Përshëndetëm lalë Fatlumit dhe zonjën Amise, dhe muartëm udhën e shpivet tona. Ndërkaq, ture zdrypur (80) nga shkalla turjel, na bini ndër vesh, me mall, sikur doni ëmbëlsisht të na shoqëroni, kënga e të vetmit dhe të moçmit kanllanot (81), që ende rroni e këndon, çdo natë vapje, ndër degët e vjetra të nespulës shekullore.

---

(1) Asnjëriu; (2) veshë (bistak) rrushi; (3) zbritur, ulur; (4) midis; (5) të grumbulluara; (6) emër mali; (7) çiliminjtë; (8) gjërat; (9) sarajit; (10) trakullijmë; (11) zverk; (12) fytyrën; (13) zgurdulloi; (14) emër vendi; (15) tani; (16) duke lexuar; (17) kaçile; (18) telikosur; (19) mushmollë; (20) zhveshur; (21) mbretëronte; (22) ktheje; (23) shtalkut; (24) vetulla; (25) stërgjyshi; (26) hijes; (27) pa vënë re; (28) u nxitua; (29) kimani; (30) kancelar; (31) dëshmi; (32) këngë epike; (33) kashelasha / gjëza; (34) përkthyer; (35) farka; (36) u mprehen; (37) ta; (38) mpije; (39) tabaka; (40) rehani / pekmez rrushi; (41) kënaqemi; (42) pa u mërzitur; (43) arritëm; (44) mu; (45) hijen; (46) gjetheshumë; (47) një lloj vigani; (48) ngjashmëri; (49) monedha; (50) qypa; (51) mendja; (52) ruanim - vështronim-; (53) shport e vogël ku kullonte djathi / farkore; (54) keca; (55) rrokulliseshim; (56) vrimat; (57) e zu për djathë; (58) zvarriseni; (59) të tmerruar; (60) kthehemi; (61) duke më hetuar; (62) ma; (63) (hëngri) sillën; (64) plehut; (65) short -hedh në short-; (66) ujit; (67) shkulloi; (68) pushtoi; (69) farkëtari; (70) teveqel; (71) të shpupurishur; (72) në mëngjes; (73) triskuj; (74) vrapoje; (75) në kurriz; (76) ligështimet; (77) rreshtuam; (78) çuam; (79) ndeshkoi; (80) zbritur; (81) bulkth nate.

## Përmbajtja

Fjoku	1
Kreshmesha	5
Llafkrat	14
Mosnjeriu	22



Via Roma 98 – 87010 Acquaformosa  
347/4776511 e-mail: malcori.firmoza@gmail.com